



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.52

2005

28 qershor

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.342, datë 20.5.2005	Për miratimin e listës së inventarit dhe transferimin e pronave të klubit të futbollit “Tirana”, në pronësi të bashkisë së Tiranës.....	1873
Udhëzim i MD nr.4566, datë 27.6.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.8045, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”.....	1885
Udhëzim i KQZ nr.20, datë 27.6.2005	Për mënyrën e lëshimit, përdorimit dhe administrimit të certifikatave të lindjes, si dokument identifikimi për efekt të ushtrimit të së drejtës së votës në zgjedhjet e datës 3.7.2005.....	1886
	Shpallje kërkesë për shpronësim me objekt shpronësimin për interes publik të objektit “Ndërtimin e varrezave publike në qytetin e Elbasanit”.....	1887

VENDIM
Nr.342, datë 20.5.2005

**PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT DHE TRANSFERIMIN E PRONAVE TË
KLUBIT TË FUTBOLLIT “TIRANA”, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të nenit 3 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listave të inventarit të stadiumit “Selman Stërmasi”, së bashku me aneksin, të stadiumit “Skënder Halili”, së bashku me aneksin, dhe të fushës sportive “Ali Demi”, si dhe transferimin e tyre në pronësi të bashkisë së Tiranës, sipas dokumentacionit që i bashkëlidhet këtij vendimi, të përbërë nga formulari, planimetritë dhe planvendosjet.

2. Ngarkohen Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe kryetari i Bashkisë së Tiranës të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryeministri
Fatos Nano

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHITETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si prona te vecanta)

Bashkia / Komuna:		Tirane		Identifikor lag. I Priftit: <u>Topi</u> / <u>Madani</u> (specifikimi i Sektorit Inventarizimit) (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) <u>Topi Madani</u> Supervizori: I Drejtorikut (Përgjegjës i Sektorit Inventarizimit) <u>Topi Madani</u> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar) <u>Topi Madani</u> Aprovoni: I drejtorit (Kryetari) <u>Topi Madani</u> (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel. firma, vlla) <u>Topi Madani</u>									
Fusha e përdorimit të pronës:		Sport											
Nr. Rend.	A			B					C			Te dhëna të tjera (Sh. të vecanta)	
	Zona Kadastre. & Indeks. Urtë	Nr. Pasturise	Lloji i Pronës	Emri i pronës Adhesi	Sip. Tot. Pronës (m ²)	Nga sip. Tot. sip. Ndert. (m ²)	Funksioni për të cilin përdoret prona	Instit. / Enti me pergj. administrat.	Instit. / Enti përdorues Stat. Juridik përdorim				
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11			
				Klubi futbollit Tirana									
1	R. S-10 8270	1/155	Shtet	Stad. Selman Stërmasi Rr. M. Gjollësia	27466.5	6577	Administrat + Ndeshje	Bashkia	K.F.T				
2	S-9, 10 8270	1/128	Shtet	Aneksi St. S. Stërmasi Rr. M. Gjollësia	7144	0	Shtervitje	Bashkia	K.F.T				
3	S-6 8240	3/86, 3/87	Shtet	Stadiumi S. Halili Qyteti i Nënësve	16800	199.1	Ndeshje	Bashkia	K.F.T				
4	S-6 8240	3/118	Shtet	Aneksi St. S. Halili Qyteti i Nënësve	7208	0	Shtervitje	Bashkia	K.F.T				
5	P-14, 15 8150	8/259	Shtet	Fusha sportive A. Demi Rr. A. Demi	17942	87.4	Shtervitje	Bashkia	K.F.T				


Fusha Sportive "ALI DEMI"

Planimetria e Ambjenteve ndihmese (*garderobe*)

Rr. "Ali Demi"

Porosites: Bashkia Tirane

Sh 1:100



$S=87,4m^2$

Punoi:

Ing. I. Priftaj

Punoi:


Ark. S. Ruli

Drejtör:

Ing. K. Gedeshi




PLANIMETRIA E KATIT PERDHE
FUSHA SPORTIVE "SKENDER HALLI" SHK: 1:100



SIP. OBJEKTIT = 100.1 M2


Puno: Ark. MIRELA GJKA
Ing. MIHAIL CICO
Ing. MIHAIL GJKA
LIC. NR. 2-26572

PLANIMETRIA E KATIT TE PARE
FUSHA SPORTIVE "SKENDER HALILI" SAK: 1:100




SIP. OBJEKTIT = 91 M2

Pano: Ark. MIRELA GJKA
Ing. MIHAIL CICO
ING. MIHAIL CICO
LIC. NR. 7-24512




PLANIMETRIA E KATI PERDHE E TRIBUNES SE
STADIUMIT "SELMAN STERMASI" SHK: 1:200



SIP OLEKTIT = 657.7 M2

Punat Ark. MIRELA GHKA
Ing. MIHAL CICO
ING. MYRAN
LIC. Nr. 1-246/12

PLANIMETRIA E KATIT TE PARE E TRIBUNESSE
STADIUMIT "SELMAN STERMAZI" SHK: 1:200




SIP. OBJEKTIV = 407.4 M2

Puneti: Ark. MIRELA GHKA
Ing. MIHAIL CICO
ING. MIHAIL CICO
LIC. NR. 2-243/2

GEN-PLAN I ANEKSIT TE STADIUMIT "SELMAN STERMAZI"
TR (S-9,10) SH 1"500



PEPQ LUKA E SHQIPËRIE	DIREKTORAT	X
BASHKIA E TIRANES	LIGJORE	X
DREJTORIA E URBANIZIMIT	KAD. URBAN	X
GEN-PLAN	ALFONZO	X
NR	DATE 25.02.95	VIZATU



UDHËZIM
Nr.4566, datë 27.6.2005

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 8045, DATË 2.12.2004 TË
MINISTRIT TË DREJTËSISË “PËR FORMËN, PËRMBAJTJEN, KARAKTERISTIKAT
DHE RREGULLAT E PAJISJES DHE ADMINISTRIMIT TË VULAVE TË NOTERËVE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të neneve 124 dhe 128 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 (i ndryshuar), të nenit 7 pika 2 të ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, (i ndryshuar) dhe të nenit 17 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, (i ndryshuar)

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.8045, datë 2.12.2004 të Ministrit të Drejtësisë “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 4 e udhëzimit nr. 8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“4. Përgatitja e vulave bëhet nga subjekte shtetërore të specializuara dhe kur kjo nuk është e mundur nga subjekte private shqiptare ose të huaja, të cilat e ushtrojnë veprimtarinë e përgatitjes së vulave me leje të nxjerrë nga organet kompetente”.

2. Pika 5 e udhëzimit nr. 8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“5. Personi i cili merr për herë të parë lejen për ushtrimin e profesionit të noterit, noteri që transferohet, noteri të cilit i janë dëmtuar vulat dhe noteri të cilit i kanë humbur vulat, i paraqesin kërkesën për vula Dhomës Kombëtare të Noterisë.

Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar me konfirmimin e Ministrisë së Drejtësisë se personi lejohet të pajiset me vulat e noterit, si dhe me të dhënat e nevojshme për përgatitjen e vulave.

Në rastin e vulave të reja, për shkak se kanë humbur të mëparshmet, matrica e vulës së re duhet të ketë detyrimisht një vendosje të ndryshme topografike të mbishkrimeve të saj, që e bëjnë të dallueshme nga vula e mëparshme”.

3. Pika 6 e udhëzimit nr.8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“6. Pasi janë përgatitur, vulat i dorëzohen përfaqësuesit të Dhomës Kombëtare të Noterisë në prani edhe të personit të ngarkuar nga Ministri i Drejtësisë. Vulat merren në dorëzim me procesverbal të firmosura nga të dy përfaqësuesit e përmendur sa më sipër dhe depozitohen për ruajtje pranë Ministrisë së Drejtësisë. Vulat ruhen dhe nuk përdoren deri në ceremoninë e betimit, kur do t'i dorëzohen noterit”.

4. Pika 8 e udhëzimit nr. 8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“8. Procedurat e përgatitjes së vulave nga Dhoma Kombëtare e Noterisë duhet të përfundojnë brenda 40 ditëve nga dita e lëshimit të lejes së ushtrimit të profesionit të noterit nga Ministri i Drejtësisë.

Në rast të mosrespektimit të afatit të sipërpërmendur nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, procesi i përgatitjes së vulave drejtohet dhe organizohet nga Ministria e Drejtësisë në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë udhëzim”.

5. Pika 11 e udhëzimit nr.8045, datë 2.12.2004 “Për formën, përmbajtjen, karakteristikat dhe rregullat e pajisjes dhe administrimit të vulave të noterëve”, ndryshohet dhe bëhet si më poshtë:

“11. Për pajisjen me vulë mbahet një procesverbal, i cili nënshkruhet nga përfaqësuesi i Dhomës Kombëtare të Noterisë, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë dhe nga noteri. Procesverbali pasqyron kohën, vendin, emrin e pjesëmarrësve dhe faktin e marrjes së vulës në dorëzim nga noteri.

Procesverbali nënshkruhet nga personat e sipërpërmendur duke i dhënë një kopje të tij Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe një kopje depozitohet në Ministrinë e Drejtësisë.

Drejtori i drejtorisë përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë kërkon nga personat të firmosin dhe të vulosin me vulat e reja në fletë të bardha format “A 4”, të cilat nevojiten për t’u depozituar në dosjen personale dhe për t’iu dërguar institucioneve të ndryshme shtetërore si model krahasues”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Fatmir Xhafaj

UDHËZIM
Nr.20, datë 27.6.2005

**PËR MËNYRËN E LËSHIMIT, PËRDORIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË
CERTIFIKATAVE TË LINDJES, SI DOKUMENT IDENTIFIKIMI PËR EFEKT TË
USHTRIMIT TË SË DREJTËS SË VOTËS NË ZGJEDHJET E DATËS 3.7.2005**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 29 pika 1, nenin 31 pika 1 germa b, nenin 100 pika 1 germa a, të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

UDHËZON:

Neni 1

Ky udhëzim ka për qëllim të vendosë rregulla për lëshimin, përdorimin dhe administrimin e certifikatave të lindjes me fotografi, të cilat do të shërbejnë për identifikimin e shtetasve që do të ushtrojnë të drejtën e votës, në zgjedhjet e datës 3.7.2005.

Neni 2

1. Zyrat e Gjendjes Civile mbajnë një evidencë të posaçme ditore për shtetasit që pajisen me certifikatë lindje me fotografi, për periudhën nga data 28.6.2005 deri në orën 19.⁰⁰, të datës 3.7.2005.

2. Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, në fund të çdo dite u dërgojnë KZZ-ve informacionin sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në ditën e votimit, ky informacion dërgohet në KZZ, si rregull çdo tre orë, por jo më vonë se pesë orë.

Neni 3

Kryetarët e njësive të qeverisjes vendore, jo më vonë se data 1.7.2005, dorëzojnë pranë KZZ-ve përkatëse listën emërore të nëpunësve të zyrës së gjendjes civile, nënshkrimin përkatës, modelin e vulës personale, si dhe modelin e vulës së zyrës së gjendjes civile.

Neni 4

Në rastet kur zgjedhësi paraqitet para Komisionit të Qendrës së Votimit me certifikatë lindje me fotografi, ky dokument nuk i kthehet më atij.

Neni 5

Certifikatat me numër serie sipas lidhjes bashkëngjitur këtij udhëzimi, nuk mund të shërbejnë si dokument identifikimi për votim.

Neni 6

Certifikatat e mbajtura nga KQV-ja, administrohen dhe dorëzohen në KZZ, së bashku me materialet e tjera zgjedhore.

Neni 7

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

Lidhja 1

Kodi 034	Numri i serisë:	004180	deri	004380
Kodi 186	Numri i serisë:	001981	deri	003600
Kodi 044	Numri i serisë:	001485	deri	002000

Kodi 034	Numri i serisë:	000587	deri	001000
Kodi 186	Numri i serisë:	001962	deri	006300
Kodi 044	Numri i serisë:	001485	deri	002000
Kodi 107	Numri i serisë:	003001	deri	006100
Kodi 174	Numri i serisë:	001517	deri	005000
Kodi 039	Numri i serisë:	002001	deri	003000
Kodi 039	Numri i serisë:	004000	deri	004200

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të objektit “Ndërtimin e varrezave publike në qytetin e Elbasanit”.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është bashkia e Elbasanit. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i shpronësimit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, për pronarin sipas listës emërore të mëposhtme.

Ky publikim do të jetë me periudhë njëjavore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrat në listën emërore kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit)

LISTA E PRONARËVE, QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË QYTETIN E ELBASANIT

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë arë	Çmimi i tokës/m ²	Vlera në total (lekë)
	Trashëgimtarët e familjes Hoxholli	4680 m ²	1925 lek	9 009 000

Sanije Zenelhxha (Hoxholli) Dallëndyshe Ahmet Palloshi Fatos Ahmet Zenelhxha Dituri Ahmet Zenelhxha Robert Ahmet Zenelhxha Sulejman Latifi Luljeta Latifi Xhaferr Zenelhxha (Hoxholli) Ymer Zenelhxha Adriatik Zenelhxha Myzejen Pamaqi Atlantik Zenelhxha Dashuni Harrija Fisnik Zenelhxha Pupulina Gjevori Drita Ballco Qemal Zenelhxha Sali Zenelhxha Leonard Zenelhxha Durim Zenelhxha Xhemile Gora Fatmira Veizi (Cankja) Mit'hat Veizi			
Bashkëpronarët e familjes Vyshka Nashifer Ymer Meti Sabaudin Ymer Vyshka Gjinovefa Ymer Shuteriqi Fatush Ymer Vyshka Lavdiye Ymer Dimashi	2502 m ²	1925 lekë	4 816 350
Gjithsej vlera totale e shpronësimit			13 825 350 lekë

Vlera e shpenzimeve procedurale për këtë shpronësim do të përballohet nga subjekti kërkues, bashkia e Elbasanit.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 28.6.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë